



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 701/prot.
12

Gramsh, më 25/03/2020

VENDIM

Nr. 20, date 25/02.2020

PER

MIRATIMIN E PLANIT VJETOR TË PRANIMEVE NË SHËRBIMIN CIVIL PËR VITIN 2020

Këshilli i Bashkisë Gramsh, në mbledhjen e tij të datës 25/02/2020 pasi shqyrtoi relacionin e P/Vendimit të paraqitur nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në mbështetje të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”; VKM nr.108, datë 05.03.2014 “Për miratimin e planit vjetor të pranimeve në shërbimin civil, pika 2,3 dhe 11,13, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë Planin e Pranimet për vitin 2020 në shërbimin civil të administratës së Bashkisë Gramsh sipas Tabelës bashkëlidhur që është pjesë përbërëse e këtij vendimi, prej 20 (njëzetë) pozicioneve të shërbimit civil, nga të cilët:
 - a. 2(dy) pozicione të kategorisë II, klasa II-b, niveli i mesëm drejtues;
 - b. 9 (nëntë) pozicione të kategorisë III-a, klasa III-a/1, niveli i ulët drejtues;
 - c. 9 (nëntë) pozicione të kategorisë IV, klasa IV-a, niveli ekzekutiv;
2. Plani prej 20 (njëzetë) pozicioneve të shpallet në Portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Web-n e Bashkisë dhe stendën e afishimeve publike të Bashkisë, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
3. Pas shpalljes publike, nga Njësia Përgjegjëse për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, të nisin procedurat për shpalljen e vendeve të lira dhe brenda 90 (nëntëdhjetë) ditësh procedurat e pranimet në shërbimin civil, nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele e ngritjes në detyrë për:
 - a. 2(dy) pozicione të nivelit të mesëm drejtues:
 - Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave, Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar; -Drejtor i Drejtorisë Juridike;
 - b. 9(nëntë) pozicione të nivelit të ulët drejtues:

-Përgjegjës i Sektorit për Koordinimin e Integritimit Europian, Ndihmës së Huaj dhe Turizmit; -Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit Financiar; -Përgjegjës i Sektorit të Buxhetit; -Përgjegjës i Sektorit të Mbrojtjes Sociale; - Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave Civile dhe Strehim; -Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve me Sipërmarrje dhe Mjedisit; -Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Aseteve Vendore; -Përgjegjës i Sektorit të Arkivës; -Përgjegjës i Sektorit të Koordinimit me Njësitë Administrative;

- c. 9 (nëntë) pozicione të nivelit ekzekutiv:- Sepcialist auditimi i brendshem (i certifikuar); -Specialist i rinisë dhe turizmit; -Specialist për pagat dhe shpenzimet; - Inspektor tatim-taksa terreni; -Specialist për emergjenca civile dhe strehim; -Specialist për koordinimin, planifikimin dhe kontrollin e projekteve; -Specialist i burimeve njerëzore; -Inspektor kontrolli veterinar; - Specialist i Ndihmës Ekonomike në Njësinë Administrative Kushovë;

Për nivelin ekzekutiv, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të zhvillojë procedurat për pranimin në shërbimin civil nëpërmjet lëvizjes paralele dhe pranimit për herë të parë në shërbimin civil.

4. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Komisionet përkatëse për Lëvizjen Paralele, Ngritjen në Detyrë dhe Pranimin në Shërbimin Civil.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Sekretar i Këshillit

Endri MEMA

Konceptoi: E.Mema

Miratoi: G.Lena

Konfirmoi: G.Lena



Kryetari i Këshillit

Greta LENA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 701/3 prot.

Gramsh, më 02/03/2020

PLANI VJETOR I PRANIMEVE NË SHËRBIMIN CIVIL

BASHKIA GRAMSH 2020

Në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”; VKM nr.108, datë 26.02.2014 ‘Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil’, pika 2,3 dhe pika 11,13, janë identifikuar 20 (njëzetë) vende të lira, për vitin 2020, pozicione sipas kategorisë, klasave, niveleve e grupeve në tabelën vijuese,

| Nr. kategoria | Emërtimi i kategorisë/klasës | Plani i pranimit viti 2018 | | | |
|---------------|---|----------------------------|----------|-----------|-----------|
| | | Gjithsej | Pension | vend i ri | vakant |
| I-b | NC niveli i larte drejtues (klasa I) | 1 | - | - | - |
| II-b | NC niveli i mesem drejtues(klasa II) | 5 | - | 1 | 2 |
| III-a | NC niveli i ulet drejtues (klasa III-a/1) | 15 | - | 5 | 9 |
| III-b | NCKategoriaekzekutive(specialist)(klasa III-IV) | 29 | - | 4 | 9 |
| TOTALI | | 50 | - | 10 | 20 |

Sekretari i Keshillit

Endri Mema

Konceptoi: E.Mema
Pranoi: G.Lena
Miratoi: -/-
Konfirmoi: -/-
Afati i ruajtës: 10 vjet

Kryetari i Këshillit

Greta LENA

